



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, si dhe nenit 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.12.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **14,690.00 €** (katëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro), për kryerjen e obligimeve që rrjedhin konform dispozitave të Marrëveshjes trevjecare për Bashkëpunim që përfshin periodën kohore 2020-2022 të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020 për zbatimin e Projektit "Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK që shtrihet në komunat Vushtrri, Skenderaj, Lipjan, Shtime, Viti dhe Kamenicë.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, 1Nr. 320-16457 të datës 18.03.2020 në të cilën përcaktohet që Komuna e Lipjanit do të participojë me 20% të bashkëfinancimit për përfituesit e përzgjedhur dhe mbështetur duke u bazuar në Kërkesën e IADK-së me numër 12-320-55638 për bashkëfinancim të projektit të parashtruar me datë 15.09.2021 lidhur me aktivitetet e realizuara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të fermerëve në sektorin e pemëve dhe perimeve dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer në Komunën e Lipjanit ku Komuna e Lipjanit obligohet të bashkëfinancoj me mjete financiare në vlerë prej 7,020.00 € dhe Kërkesën e parashtruar poashtu nga IADK me numër 12-320-60319 e datës 30.09.2021 lidhur me aktivitetet e zhvilluara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të rinjëve në sektorin e bujqësisë dhe menaxhimit të biznesit si dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer të rinjë dhe poashtu përkrahja e grave me trajnime profesionale për përpunim të qumështit dhe përpunim të pemëve dhe perimeve në vlerë prej 7,670.00 ku vlera e përbashkët për këto projekte përfshin shumën prej 14,690.00 € (katëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro), të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës- kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural .

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

15Nr. 400-78035

Lipjan, më 24.12. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Dani Azemi

